# DËSHMI ARKIVI

**A-454054**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Jep llogari para popullit”/ Rama replikon me Bardhin: Sa më shumë t’i merrni për budallenj, aq më shum ë do ta merrni ballit nga shqiptarët në zgjedhje |
| ADRESA | `https://dosja.al/politike/jep-llogari-para-poullit-rama-replikon-me-bardhin-sa-me-shume-ti-merrni-i514775` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 07:08:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 07:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4e0deeb4ccd88acc2df7e689300f02e111092884bd4241be4cc50a05859b7fc8` |
| TEKSTI | `903b37c5efe0da226e19372560157e51bc829f3566189207e658b057f6fe86fa` |
| PAMJA | `53a05d9bb53862fe829bf14b428877f15fc870219935b320aa94932297ce859a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `52b0e80f4f5d6c8cdada8e2ac4d393260de0e0d3d7556a3e017302b54712ba67` |
| E MËPARSHMJA | `9540c766da554b9a738ac1f26e76be19c8d4ce172fbfcfeebcedc91f469d97d2` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/52b0e80f4f5d6c8cdada8e2ac4d393260de0e0d3d7556a3e017302b54712ba67`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

13 ORE ME PARE
110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mblidhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

18 ORE ME PARE
Vendimi i Hagës nxit protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

23 ORE ME PARE
Pagat e magjistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardhi: Puç kushtetues

23 ORE ME PARE
"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

Politike

# "Jep llogari para popullit"/ Rama replikon me Bardhin: Sa më shumë t'i merrni për budallenj, aq më shumë do ta merrni ballit nga shqiptarët në zgjedhje

Bardhi kundërshtoi deklaratën e Ramës se biznesmeni nuk ka marrë para nga shteti shqiptar dhe i kërkoi llogari edhe për pagat e magjistratëve.

dosja
18 Shtator 2026, 09:00
Nga E.d



Edi Rama

**TIRANA-** Një përplasje ka ndodhur gjatës seancë plenare në Kuvend, ku kryeministri Edi Rama është përplasur me kreun e grupit parlamentar të PD-së Gazment Bardhi. Kjo përplasje erdhi për arbitrazhin me Francesco Becchettin.

Bardhi kundërshtoi deklaratën e Ramës se biznesmeni nuk ka marrë para nga shteti shqiptar dhe i kërkoi llogari edhe për pagat e magjistratëve. Ai shtoi se kryeministri po shkel vazhdimisht vendimet e Kushtetueses dhe për këtë duhet t'i jap një përgjigje popullit shqiptar.

Në lidhje me këtë, kryeministri deklaroi se Becchetti ka marrë zero lekë nga shteti dhe iu përgjigj Bardhit me ironi. Kjo duke thënë se opozita do ta marrë "ballit" nga shqiptarët në zgjedhje.

***Gazment Bardhi:*** *Mendova që edhe sot do ishe thjesht kryeministër karton, por mirë që e more tre minuta fjalën që të justifikosh që nuk të ka kthyer Taulanti thjesht në karton që vjen në Kuvend sa herë i duhet vota këtyre. Së dyti, subjekti në fjalë ka zero interes për ne si opozitë. Ajo që ti këtu deklaron përpara shqiptarëve dhe Kuvendit ka shumë rëndësi. Fillimisht the që s'ka vendim arbitrazhi. Doli që kishte vendim arbitrazhi. Fillimisht the që subjekti në fjalë ka marrë zero lekë nga buxheti i shtetit. Pas 30 sekondash, 'ato që i ka marrë nga Albcontrol-i', a thua se ato nuk janë të shqiptarëve dhe të buxhetit të shtetit, 'do t'i kthejë kokërr më kokërr'. Pra, do të thotë që kthehet një gjë që është marrë, se në qoftë se nuk është marrë, nuk ka çfarë kthen.*

*Por do bëje mirë që t'i përgjigjeshe akuzës së kolegut, jo për këtë çështje, se këtë çështje ke 10 vjet që na thua 'do t'i ndodhë një gjë atij, se ai po hetohet'. E kemi dëgjuar këtë përrallë dhjetëra herë këtu në seancë plenare. Sot mendova që do merrje fjalën dhe do na shpjegoje pse po shkel vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pse ke futur në kolaps sistemin e drejtësisë. Mendova se do na shpjegoje pse i ke dhënë Roni Yeffet 34 milionë euro dhe thua*

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 09:22
Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21
Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

*'nuk kam lekë për t'i paguar pagat gjyqtarëve dhe prokurorëve'. Mendova se kishe ardhur të shpjegoje këtë.*

*Po për t'u marrë me subjektin në fjalë, ke nja 14 vite deri tani. S'ia ke dalë, për fatin e keq të Shqipërisë, se ato lekë nuk janë të tuat, edhe pse veprimet janë të papërgjegjshme, të tuat personale dhe të rrethit tënd të ngushtë, siç thotë vendimi i arbitrazhit. Por ato lekë janë të shqiptarëve dhe unë ndiej keqardhje që ai zotëria, për papërgjegjshmëri të qeverisë që ti drejton, i merr paratë qytetarëve të varfër shqiptarë, në vend që t'i çojmë për rritje pensionesh e për rritje rrogash për qytetarët shqiptarë e për ndihmë më të lartë ekonomike për familjet e varfra dhe që s'kanë bukë të hanë çdo ditë.*

*Por se çfarë marrëdhënie ke ti me të, herë miqësi, herë pastaj ta prishi, herë do ta fusësh në burg, herë e kërkon drejtësia, për momentin ai ka marrë lekët e shqiptarëve për shkak të papërgjegjshmërisë tënde, e përsëris, i ka futur në xhep. Do kthehen? S'dimë a do kthehen apo jo, se nga 's'ka marrë' te 'do kthehen' është një hapësirë shumë e madhe. Por, meqë ke ardhur në seancë, përgjigju pse shkel në mënyrë të vazhdueshme vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë? Për këtë do duhet t'i jepni llogari Parlamentit.*

***Edi Rama:*** *Winston Churchill thoshte se hajvani është dikush që jo vetëm nuk ndryshon mendje, por nuk ndryshon as argument. Ndërkohë që unë jam këtu prezent me zërin tim, e dëgjuan të gjithë, unë thashë që ai ka marrë dhe ka për të marrë zero lekë. Nuk thashë, sepse nuk ka ndodhur, se po të ndodhte kjo do ishte në librat e llogarive të shtetit shqiptar, që ai ka marrë dhe do t'ia marrim mbrapsht. Unë thashë që ai ka marrë zero lekë. Fondi është një fond i ngrirë deri në fund të procesit.*

*Pikërisht sepse, ndryshe nga çfarë mendoi ai që u kthye në heroin e këtyre këtu, që nuk lënë pleh pa e kthyer në hero për të sulmuar me çdo kusht dhe me çdo çmim, edhe me çmimin e përbaltjes së Shqipërisë, palën tonë. Ndërkohë që sot, pikërisht pse çështja e arbitrazhit nuk u mbyll ashtu sikundër ëndërronte ai subjekt, ne jemi në disa procese dhe zero lekë ka marrë, zero lekë do të merren. Kjo është e vërteta.*

*Për sa u përket pastaj 34 milionëve e 450 milionëve, e 70 milionëve, e 80 milionëve, kjo është një përpjekje shumë e vjetër që ka po të njëjtin rezultat: rrokanisje pa fund kokës së shqiptarëve dhe, në fund, ballit nga shqiptarët sa vijnë zgjedhjet. Dhe përsëri shqiptarët ballit, sa vijnë zgjedhjet, do t'ju japin për të gjitha këto që bëni. Sepse sa më shumë t'i merrni për budallenj, aq më shumë do ta merrni ballit nga shqiptarët në çdo palë zgjedhje. Kjo është e vërteta.*

*Për sa i përket pastaj çështjes në fjalë, unë do flas, patjetër që do flas, dhe do flas kur dëshiroj unë, jo kur vendosni ju. Po do flas, këtu jam për të folur. Po dëgjoj njëherë të gjitha mendjet e ndritura të mendimit juridik të Parlamentit dhe pastaj do them dhe unë ato që mendoj si një piktor i rëndomtë.*/**Dosja.al**

gazment bardhi | francesco becchetti | edi rama

## Sondazh

Poll


Politike

18 Shtator 2026, 08:53

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama për



BOTA 18 SHTATOR 2026, 07:15

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

## më të klikuarat

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente false/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

## insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

## Moti

Powered by tomorrow.io

## opozitën: Të të përzënë nga protesta quhet “amanet mushkat, se kuajt ikën”

Edi Rama TIRANA- Seanca plenaret e zhvilluar deri në orët e para të mëngjesit është shoqëruar me tensione dhe përpl...

---

### Pagat e magjistratëve/ Rama: Të kërkosh rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

Politike

18 Shtator 2026, 08:37

---

### Rama për Gjykatën Kushtetuese: Detyra jote është të mos na lejosh ta ngremë dorën gabim, jo të na diktosh si ta ngremë!

Politike

18 Shtator 2026, 08:24

---

### "SPAK dhe GJKKO janë dy suksese të reformës në drejtësi"/ Rama: KLP dhe KLGJ kanë falimentuar

Politike

18 Shtator 2026, 08:16

---

### "Kush është ai pushtet që i vendos afat Kuvendit?"/ Rama për pagat e magjistratëve: Askush nuk mund t'i diktojë Kuvendit kur të mblidhet

Politike

18 Shtator 2026, 08:07

---

Politike

18 Shtator 2026, 07:57

## Rama për pagat e magjistratëve: Lëvizjet e koordinuara mes shoqatave dhe gjyqësorit dëmtojnë Republikën e Shqipërisë

Edi Rama TIRANA- Kryeministri i vendit, Edi Rama ka komentuar krizën me pagat e magjistratëve, ndërsa foli edhe për

komentuar krizën me pagat e magjistratëve, ndërsa foli edhe për një ...

### Kuvendi miraton me 84 vota projektligjin për pagat e magjistratëve/ Rama voton pro, Berisha mungon

Politike

18 Shtator 2026, 07:51

### “Çështja Becchetti”/ Rama: E ka fituar arbitrazhin por do marrë zero lekë nga shteti shqiptar

Politike

17 Shtator 2026, 23:45

### "Një prokuror rrethi dërgoi OPGJ-në në degën e Thesarit"/ Malaj: U tha punonjësve ekzekutoni pagesat, ose do ju arrestojmë

Politike

17 Shtator 2026, 22:40

### Protesta kundër vendimit të Speciales/ Djali i Thaçit dhe Veselit i bashkohen qytetarëve: Populli është me UÇK-në

Politike

17 Shtator 2026, 22:37

MË SHUMË





Protesta e 110-të kundër qeverisë/ Qytetarët rrethojnë komisariatin nr.1, thirrje: Lironi çunat


Bardhi:Kompania që u kap me41kilogramë kokainë, përfitojë nga Qeveria1milion euro nga fondet e IPARD


Diskutimet për pagat e magjistratëve, kryeministri Edi Rama i bashkohet seancës në Kuvend


Marshim i protestuesve/ Policia bllokon hyrjet që të çojnë drejt Kuvendit

## Protesta e 110-të kundër qeverisë/ Qytetarët rrethojnë komisariatin nr.1, thirrje: Lironi çunat

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE


Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

**AKTUALITET**
**POLITIKE**
**EKONOMI**
**BOTA**
**SPORT**
**ART&ARGËTIM**
**INSIGHTS**
**EDITORIAL**

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.